

# LËVIZJET E SHTETASVE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure  
(ESMS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

1. Kontakt .....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore .....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional .....	4
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit .....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes .....	6
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia .....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria .....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria .....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave .....	9
18. Përpunimi statistikor .....	9
19. Komente .....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike.
1.3. Personi i kontaktit	Ervisa Bushati
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:ebushati@instat.gov.al">ebushati@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	25.10.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	25.10.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	25.10.2022
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Turizmi ka një rol potencial në zhvillimin e rajoneve të veçanta të vendit, duke kontribuar në punësim dhe mirëqënie, zhvillim të qëndrueshëm të qarqeve, etj. Statistikat e Lëvizjes së Shtetasve paraqesin të dhëna të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë)</li> <li>• Pikave kufitare</li> <li>• Qëllimit të udhëtimit të shtetasve të huaj</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve.</li> </ul>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhëna mbi Lëvizjen e Shtetasve në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Hyrjet dhe daljet</b> përfshijnë të gjitha hyrjet e daljet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).</p> <p><b>Hyrjet</b> janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.</p> <p><b>Daljet:</b> përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.</p> <p><b>Vizitor:</b> Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.</p> <p>Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:</p> <p><i>Qëllime personale</i> të cilat grupohen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;</li> <li>2. Trajtime shëndetësore</li> <li>3. Qëllime fetare;</li> <li>4. Udhëtarë tranzit.</li> </ol> <p><i>Kategoria e biznesit</i> që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.</p>
3.5. Njësia statistikore	Numri i hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.
3.6. Popullata statistikore	Të gjithë shqiptarët dhe të huajt që kanë mbërritur dhe kanë dalë nga territori Shqiptar.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e Lëvizjes së Shtetasve mbulojnë të gjithë territorin e vendit.

3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat datojnë që nga viti 2001.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve publikohen në shifra absolute dhe në përqindje në lidhje me numrin e hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi Lëvizjen e Shtetasve është mujore. Ky raport i përket vitit referencë 2022.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>➤ Baza ligjore në nivel vendi për prodhimin e treguesve mbi Lëvizjen e Shtetasve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare</a></li> <li>• <a href="#">Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026</a></li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Lëvizjes së Shtetasve transmetohen në Organizatën Botërore të Turizmit (më poshtë referuar OBТ).
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësisve statistikore. INSTAT ndërmer të gjitha masat e duhura për të

	<p>parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p><b>8. Politika e botimit</b></p>	
<p>8.1. Kalendari i publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve</p>	<p><a href="#">Kalendari</a> i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesit i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> </ol>

	<p>3. Publikimi mbi “Lëvizjet e Shtetasve”;</p> <p>4. Seksioni <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, për përdoruesit e jashtëm.</p>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Statistikat mbi “Lëvizjet e Shtetasve” publikohen në bazë mujore.
<b>10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të mbi “Lëvizjet e Shtetasve”. Formatit i njoftimit për shtyp ka ndryshuar duke u përmirësuar sipas kërkesave të përdoruesve; ky format është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp mbi “Lëvizjet e Shtetasve” publikohet në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Rezultatet e Lëvizjes së Shtetasve gjenden të botuara në botimin “Lëvizja e shtetasve në Shqipëri”, “Turizmi në Shifra”, “Shqipëria në shifra” dhe “Vjetari Statistikor Rajonal”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Lëvizjet e Shtetasve</a></li> <li>• <a href="#">Turizmi në Shifra</a></li> <li>• <a href="#">Vjetari Statistikor Rajonal</a></li> <li>• <a href="#">Shqipëria në shifra</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat për Lëvizjen e Shtetasve janë të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT, seksioni <a href="#">Databaza</a> .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e Lëvizjes së Shtetasve nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31 Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kërkesë të dhënash</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi Lëvizjen e Shtetasve është e bazuar në "Përmbledhjen e Statistikave të Turizmit" të OBT, manualët dhe rregulloret e OBT. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodogjinë</a> mbi Lëvizjen e Shtetasve.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi statistikave të “Lëvizjes së Shtetasve” për qëllime të

	brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.17/2018, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhënat e Lëvizjes së Shtetasve krahasohen me të dhënat e Lëvizjes së Shtetasve të një viti më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit mbi Lëvizjen e Shtetasve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike</li> <li>• Universitetet</li> <li>• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>• Bizneset</li> <li>• Kërkues, student dhe grupe të tjerë të ngjashme.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me statistikën mbi “Lëvizjen e Shtetasve” për vitin 2021 janë rreth 25.528.</p> <p>Gjatë 2021, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme mbi “Turizmin” është vlerësuar me 3.55 (71 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave mbi “Lëvizjen e Shtetasve” për vitin 2022 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026). Të dhënat e prodhuara janë në nivelin më të detajuar të kërkuar.</p>

	Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për Lëvizjen e Shtetasve 2022, është 100%.								
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Informacioni mblidhet në mënyrë të listuar nga burimet administrative. INSTAT nuk kryhen vrojtme për të dhënat e “Lëvizjes së Shtetasve”. Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Informacioni mbi Lëvizjet e Shtetasve publikohet afërsisht 25 ditë pas përfundimit të muajit referues (T+25), sipas datës së paracaktuar në kalendarin e publikimit INSTAT.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/25/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>25</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2022	Data e publikimit	10/25/2022	Afatet kohore	25		
Periudha referuese	9/30/2022								
Data e publikimit	10/25/2022								
Afatet kohore	25								
14.2. Përpikmëria	<p>Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin e botimeve. Publikimi i të dhënave si pjesë e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>9/30/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>10/25/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/25/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	9/30/2022	Data e shpallur	10/25/2022	Data e publikimit	10/25/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	9/30/2022								
Data e shpallur	10/25/2022								
Data e publikimit	10/25/2022								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									



15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi.
15.2. Krahasueshmëria kohore	Informacioni statistikor mbi Lëvizjen e Shtetasve grumbullohet në të njëjtën mënyrë duke datuar nga viti 2001, duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 22 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=22).
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave mbi Lëvizjen e Shtetasve pranë sektorit të Statistikave Afatshkurtra është: 1 punonjës.
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.</p> <p>Kryhen rishikime në fund të vitit mbi të dhënat e “Lëvizjes së Shtetasve” për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve sigurohen nëpërmjet burimit administrativ, konkretisht nga; Ministria e Brendshme, (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen në baza mujore.

18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lëvizjes së shtetasve grumbullohet nga Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit) duke mbledhur informacion konkretisht mbi numrin e hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare).
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole kryhen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komente</b>	
<b>Aneks</b>	